



Data: 29/07/2019

Ref.: 1352/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” në nivel institucional.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Menaxhim Biznesi, BSc, 180 ECTS, maksimumi 400 studentë për vit akademik
 - Menaxhim Biznesi, MSc, 120 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik
 - Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis, BSc, 180 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik
 - Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS, maksimumi 450 studentë për vit akademik
 - Agromjedis dhe Agroekologiji, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
 - Teknologji Ushqimore, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
 - Teknologji e Prodhimit Bimore, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
- III. Nuk akreditohet programi i studimit në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka”:
 - Menaxhim në Mjedis dhe Turizëm, MSc, 120 ECT
- IV. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- V. Obligohet Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi. AKA ka organizuar tri vizita të ndara me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka", me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit. Vizita e parë është realizuar me 11.04.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Anca Prisacariu dhe Oana Sarbu, vizita e dytë është realizuar me datë 24.04.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Reiner Doluschitz dhe Joachim Muller, ndërsa vizita e tretë është realizuar me datë 10.05.2019 me këtë përbërje Mirjana Pejic Bach, Nevenka Vaclek dhe Salvador Rus Rufino.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapituj të standardeve të Manualit të Akreditimit, Universiteti i Pejës plotëson pjesërisht 10 nga to (Deklarata e Misionit dhe Objektivat Institucionale; Planifikimi Strategjik, Qeverisja dhe Administrimi; Planifikimi dhe menaxhimi financiar; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Mësimdhënia dhe Mësim marrja; Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional, Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe infrastruktura; Bashkëpunimi institucional) ndërsa nuk plotëson kapitullin e standardit për Sigurimin e Cilësisë.

Sa i përket deklaratës së misionit dhe objektivave institucionale, ekspertët në mes tjerash, kanë gjetur se deklarata e misionit të Universitetit të Pejës është deri në masën 53% identike me deklaratën e misionit të një universiteti tjetër publik në Kosovë, pastaj edhe ky formulim i tillë sipas ekspertëve nuk është i përshtatshëm për një institucion të arsimit të lartë dhe se vështirëson që institucioni të identifikohet me të. Për më tepër ekspertët kanë deklaruar se anëtarët e stafit akademik nuk kanë mundur të kujtojnë pjesë të misionit të institucionit dhe se institucioni nuk ka dëshmuar për një proces të hartimit dhe rishikimit të deklaratës së misionit.

Sa i përket planifikimit strategjik, qeverisjes dhe administrimit, ekspertët ndër të tjera kanë vënë në pah se planifikimi strategjik i universitetit nuk është hartuar në konsultim me palët e treta dhe punëdhënësit, dhe se kanë hasur në vështirësi për të identifikuar aktivitetet e planifikuara për të arritur nën objektivat dhe objektivat e strategjisë. Po ashtu edhe afatet kohore të përcaktuara nga strategjia sipas ekspertëve

janë shumë të përgjithshme dhe mbetet shumë e paqartë se si universiteti i jep përparësi veprimeve të tij. Tutje ekspertët kanë deklaruar se ka mungesë të indikatorëve për matjen e arritjeve të objektivave strategjike dhe se mungojnë indikatorët e performancës të cilët do të mund të asistojnë universitetin të vlerësojnë në mënyrë periodike arritjen e objektivave. Po ashtu ekspertët kanë deklaruar se studentët nuk janë të përfshirë në të gjitha strukturat e Universitetit dhe se mekanizmat për përzgjedhjen e tyre nuk janë plotësisht demokratike dhe se ekzistojnë kritere diskriminuese të cilat kufizojnë të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar.

Sa i përket standardeve për planifikim dhe menaxhim financiar, ekspertët ndër të tjera, kanë deklaruar se universiteti duhet të bëjë më shumë punë që të diversifikojë burimet e financimit dhe të investojë në kapacitetet e tij institucionale për të tërhequr fonde të hulumtimit brenda dhe jashtë vendit. Në lidhje me çështjet e integritetit akademik, përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike, ekspertët ndër të tjera kanë konstatuar që pavarësisht ekzistimit të Kodit të Etikës menaxhmenti i universitetit nuk është i njohur me përmbajtjen e tij dhe se gjatë vizitës nuk kanë mundur ti përgjigjen edhe pyetjeve të përgjithshme dhe fare pyetjeve më specifike. Po ashtu ekspertët kanë deklaruar se proceset dhe mekanizmat e dedikuara për implementimin e Kodit nuk janë të qarta as për Këshillin e Etikës. Po ashtu në këtë kapitull, ekspertët kanë deklaruar se institucioni nuk kanë ndonjë softuer kundër plagjiaturës dhe se për momentin kjo çështje varët nga vet profesorët të cilët arrijnë të identifikojnë punën plagjiatë të studentëve dhe se kjo çështje për ekspertët është serioze duke pasur parasysh masën e madhe të referencave të cilat përdoren në botë dhe qasjen në informatat online.

Sa i përket publikimi të informatave , ekspertët kanë deklaruar se institucioni nuk ka informacione të mjaftueshme të publikuara sa i përket stafit akademik, hulumtimit dhe aktiviteteve akademike, programeve të ofruara, numrin e studentëve të regjistruar, rezultatet e të nxëniet, etj.

Sa i përket kapitullit për menaxhimin e cilësisë, ekspertët ndër të tjera kanë deklaruar se institucioni ka keqkuptuar konceptin e kulturës së cilësisë brenda komunitetit akademik të universitetit. Sipas tyre, zhvillimi i kulturës së cilësisë në institucion nuk mbështet zhvillimin e aktiviteteve të institucionit, dhe se kjo nuk është e përcaktuar mirë, nuk është shpërndarë dhe nuk është promovuar në universitet. Pavarësisht se ekziston një Plan Strategjik për sigurimin e cilësisë, ekspertët kanë deklaruar se ky plan është një strategji e përgjithshme e institucionit duke pasur parasysh se shumica e përmbajtjes së tij nuk i referohet sistemit të menaxhimit të cilësisë, mirëpo masave të përgjithshme që kanë për qëllim rritjen e cilësisë së praktikës dhe aktiviteteve institucionale. Po ashtu shumica e rezultateve të pritura nuk janë arritur dhe as nuk janë bërë pjesë e Strategjisë Zhvillimore të vitit 2017 në mënyrë që të sigurohet një lidhje koherente dhe vazhdimësi në mes të dy planeve. Ekspertët kanë deklaruar se funksionet e sigurimit të cilësisë nuk janë të integruara në një cikël të definuar të planifikimit, implementimit, vlerësimit dhe rishikimit dhe se ekspertët kanë hasur në vështirësi të marrin informacione për shembuj të mjaftueshëm të ndryshimeve që kanë ndodhur në baza të të dhënave të mbledhura nga vlerësimet e cilësisë. Ekspertët gjithashtu kanë deklaruar se funksionet e sigurimit të cilësisë nuk janë integruar në një strategjitë normale të planifikimit dhe zhvillimit dhe se sistemi i sigurimit të cilësisë nuk ka ndonjë kontribut në monitorimin e arritjes së objektivave strategjike.

Sa i përket vlerësimeve, ekspertët kanë deklaruar se universiteti kryen vlerësime të lëndëve nga studentët dhe se asnjë akter tjetër nuk e ka konfirmuar ekzistimin e instrumenteve të tjera për mbledhjen e të

dhënave. Prandaj ekspertët deklarojnë se sistemi i sigurimit të cilësisë së universitetit nuk mbulon gjitha aspektet e aktiviteteve institucionale.

Sa i përket mësimdhënies dhe mësim marrjes, ekspertët kanë deklaruar se universiteti ka politika dhe procedura për programet e studimit mirëpo nuk është e qartë se si i monitoron ato. Po ashtu ekspertët kanë deklaruar se universiteti nuk ka ofruar dëshmi për të dhëna nga të diplomuarit apo punëdhënësit të cilat do të mund të përdoren në monitorimin e cilësisë së programeve të studimit, dhe se nuk ka asnjë dëshmi se këta të fundit përfshihen në zhvillimin dhe hartimin e programeve të studimit. Ekspertët kanë deklaruar se raporti staf akademik dhe student nuk ofron ndonjë garanci duke pasur parasysh implementimin e plotë të të mësuarit me studentin në qendër. Kjo çështje sipas ekspertëve është adresuar edhe në raportin e kaluar të akreditimit mirëpo situata nuk është përmirësuar.

Sa i përket kapitullit të Hulumtimit, ekspertët kanë konstatuar se universiteti nuk ka miratuar një Plan Zhvillimor të Hulumtimit dhe se objektivat e hulumtimit janë pjesë të Strategjisë Zhvillimore 2017-2022 të cilat ekspertët i quajnë shumë ambicioze. Ekspertët gjatë vizitës nuk kanë arritur që të marrin detaje se si janë përcaktuar prioritetet e hulumtimit; nëse stafi akademik ka publikuar të paktën një publikim/produkt për tre vitet e kaluara dhe se publikimi i stafit akademik lidhet me procesin e promovimit dhe marrjes së kontratës. Pas procesit të promovimit, universiteti nuk ka ndonjë masë e cila i inkurajon stafin akademik që të vazhdojnë aktivitetin e tyre të hulumtimit. Ekspertët nuk kanë arritur të identifikojnë strategjinë e universitetit për të mbështetur dhe inkurajuar angazhimin e stafit në hulumtim. Sa i përket përfshirjes së studentëve në hulumtim, ekspertët nuk kanë arritur të identifikojnë ndonjë pjesëmarrje aktive të studentëve në proceset e hulumtimit edhe pse kjo është identifikuar si nën-objektiv i Strategjisë Zhvillimore të Universitetit.

Sa i përket kapitullit të stafit, punësimit dhe zhvillimit profesional të tyre, ndër të tjera, ekspertët kanë deklaruar se dispozitat sa i përket vlerësimit të performancës, proceseve mbështetëse, dhe zhvillimit profesional nuk janë gjetur në ndonjë rregullore specifike. Politikat dhe procedurat e stafit sipas ekspertëve nuk janë centralizuar në një formë të libri të punësimit i cili i jepet në dispozicion stafit akademik me rastin e punësimit në universitet. Po ashtu ekspertët kanë konstatuar se stafit nuk i jepen indikatorë të performancës përmes së cilave do të duhet të reflektojnë nëse pritjet e tyre ndaj universitetit janë plotësuar; stafit nuk i jepet orientim efektiv për tu njohur me universitetin dhe shërbimet e tij me rastin e punësimit në universitet, dhe se raporti në mes të studentëve dhe stafit akademik nuk është adekuat. Sipas ekspertëve stafi nuk ka hartuar një politikë apo procedurë të vlerësimit të stafit akademik dhe se nuk ka ndarje të detyrave në mes të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Sigurimit të Cilësisë për sa i përket vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe administrativ. Po ashtu ekspertët nuk kanë arritur të marrin asnjë dëshmi për forma të ndryshme të vlerësimit të stafit të cilat kanë përcaktuar në Statutin e Universitetit, dhe se universiteti nuk ka arritur të dëshmojë ndonjë format apo të dhëna për implementimin e tyre. Ekspertët kanë konstatuar se universiteti nuk ka ndonjë proces për të vlerësuar rastet kur duhet të bëhet zhvillim në rastet e identifikuar si sfiduese; universiteti nuk ka një plan të qartë për zhvillimin profesional të stafit mirëpo kjo çështje është përfshirë në Planin Zhvillimor të universitetit mirëpo prioritet e përcaktuara aty janë të pamjaftueshme dhe të paplotësuar. Ekspertët kanë deklaruar se institucioni nuk ka një qasje të

strukturuar për të identifikuar nevojat e zhvillimit të stafit akademik dhe se kjo fushë nuk është shumë me prioritet për universitetin.

Sa i përket kapitullit për administrimin e stafit dhe shërbimet mbështetëse, ekspertët kanë deklaruar se universiteti nuk i ka të publikuara informatat sa i përket shërbimeve të studentëve para aplikimit të tyre në universitet dhe nuk organizohen ditët orientuese për studentët e rinj. Ekspertët kanë konstatuar se universiteti nuk ka mekanizëm për mbledhjen e të dhënave për të vlerësuar shërbimet administrative dhe mbështetëse për studentë, dhe se nuk ka instrument për mbledhjen e të dhënave për vlerësimin e mësimdhënësve sa i përket shërbimeve mbështetëse dhe administrative.

Sa i përket kapitullit për hapësirat dhe infrastrukturën, ekspertët kanë deklaruar ndër të tjera se ambientet e universitetit nuk ofrojnë një vend adekuat, të pastër, atraktiv dhe të mirëmbajtur për gjitha ndërtesat e universitetit, disa prej tyre sipas ekspertëve janë të papërshtatshme për procesin e mësimdhënies. Ekspertët kanë konstatuar se në disa fakultete është shqetësues fakti i mungesës së instrumenteve, apo librave dhe materialeve elektronike për mësim marrje; mungojnë hapësirat e përbashkëta për takime të studentëve dhe hapësira rekreative, ndërsa hapësirat e fakultetit nuk i përshtaten studentëve me nevoja të veçanta. Në lidhje me bashkëpunimin institucional, ekspertët kanë konstatuar se universiteti nuk ka zhvilluar një politikë apo strategji për bashkëpunimin institucional dhe/ apo ndërkombëtarë. Kjo çështje përfshihet në Planin Zhvillimor të Universitetit megjithatë ekspertët kanë deklaruar se mjetet e alokuara për këtë komponent janë të pamjaftueshme. Ani pse universiteti ka prezantuar një numër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, ekspertët kanë deklaruar se shumica e tyre janë jo aktive. Sipas ekspertëve, universiteti merr pjesë në projekte ndërkombëtare mirëpo progres i vogël është shënuar që nga vizita e kaluar e akreditimit; vetëm 2 konferenca ndërkombëtare janë organizuar në vitin 2018! asnjë ndihmë nuk i ofrohet stafit për të zhvilluar marrëveshje të bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtarë dhe se bashkëpunimi ndërkombëtarë i stafit është minimal dhe zakonisht bazohet në iniciative individuale të tyre. Sipas ekspertëve, ka pak dëshmi për angazhimin e punëdhënësve lokal dhe profesionistëve në punën e komisioneve të programeve të studimit të universitetit. Rrjedhimisht, sipas tyre nuk ka komunikim sistematik të universitetit për të konsultuar industrinë në regjion për kërkesat e tyre në lidhje me të diplomuarit e Universitetit. Duke u bazuar në gjetjen e ekspertëve si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitiv II të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se programet e studimit të cekura më sipër përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e riakreditimit. Megjithatë, duke pasur parasysh Nenin 15, paragrafin 6, të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011, i cili përcakton se *"Nëse një bartës i licencuar i arsimit të lartë nuk arrin të fitojë akreditimin apo riakreditimin institucional, kjo do të rezultojë me një organizim tjetër të akreditimit jo më vonë se pas një viti"* dhe paragrafin 7 i cili përcakton se *"Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës, bartësi mund të ankohet në organin kompetent konform Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit të Konfliktit Administrativ"*, Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" i ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj në të gjitha programet e studimit me akreditim valid , përfshirë programet e studimit të cekura në dispozitivin II, për vitin


akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional sipas dispozitave të cekura më sipër. Studentët e regjistruar në programet e studimit para marrjes së vendimit për mos riakreditim institucional, vazhdojnë studimet e tyre në përputhje me statutin e institucionit si dhe me dispozitat e tjera në fuqi.

Sa i përket programit të studimit Menaxhimi i Ambinetit dhe Turizimit, MSc, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Sipas tyre, mangësitë kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim janë stafi akademik dhe procesi dhe përmbajtja mësimore e programit të studimit. Ekspertët kanë deklaruar se një element shqetësues është fakti që shumica e profesorëve të përcaktuar për të dhënë ligjërata në program janë koordinator të katër ose edhe pesë lëndëve në programin e studimit. Ani pse institucioni kishte deklaruar që këta ligjërues do të mbajnë ligjëratat me profesorë të tjerë, kjo politikë ishte aprovuar për vetëm dy pjesëtar të stafit. Sipas kësaj, ekspertët kanë deklaruar se ky fakt fuqishëm nënkupton se përfundimisht Universiteti ka mangësi të stafit të kualifikuar i cili mund të angazhohet në këtë program të studimit Master. Po ashtu duke pasur parasysh se shumica e stafit të njëjtë është i angazhuar po ashtu edhe në nivelin Bachelor, sipas ekspertëve kjo nënkupton se të njëjtit do të mbingarkohen me përgjegjësi të mësimdhënies dhe hulumtimit, duke cenuar kështu seriozisht cilësinë e programit. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së procesit mësimor, ekspertët kanë vërejtur dyfishime të shumta në disa lëndë dhe në disa raste kanë vërejtur që rezultatet e të nxëniet nuk janë definuar në mënyrë të përshtatshme. Përfundimisht ekspertët kanë deklaruar se i gjithë programi të studimit i mungon një planifikim strategjik përgjatë gjitha lëndëve dhe se është e nevojshme një koordinim më i fuqishëm në mënyrë që të shmangen dyfishimet dhe që kompetencat dhe aftësitë e arritura me programin e studimit ti korrespondojnë nivelit të këtij programi. Rrjedhimisht, ekspertët kanë kolauduar se programi i studimit nuk përmbush standardet e akreditimit dhe kanë dhënë rekomandim për mos akreditimin e këtij programi të studimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë